

2256/7



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BELSH
KËSHILLI BASHKIAK

ADRESA: BELSH

bashkiabelsh@hotmail.com

Nr. 8 prot

Belsh më 23/01/2019

Lënda: Kthim -Përgjigje.

Drejtuar: Sektorit Financiar dhe Shërbimet Mbështetëse, Prefektura e Qarkut Elbasan.

Mbështetur në ligjin Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", ligjin 9632, datë 30.10.2006 i ndryshuar, VKM Nr. 132, datë 07.03.2018 dhe aktit tuaj të konfirmimit Nr. 2256/1, datë 04/01/2019 "Mbi ligjshmërinë e aktit", përsa i përket pikës A "Taksa mbi pasurinë e paluajtshme" të vendimit Nr. 66, date 17.12.2018 " Për nivelin e taksave vendore, kundravajteve administrative dhe gjobave në Bashkinë Belsh, si dhe për mënyrën e administrimit të tyre", bashkangjitur po ju dërgojmë informacionin e kërkuar!.

Faleminderit për mirëkuptimin tuaj!.

SEKRETARI KËSHILLIT
Adrian ZEKTHI

KRYETARI BASHKISE
Arif TAFANI

Në mungesë dhe me Porosi
Sekretari i Përgjithshëm
Mustafa ÇARÇIU



A) TAKSA MBI PASURINË E PALUAJTSHME:

Në taksën mbi pasurinë e paluajtshme përfshihen:

1. Taksa mbi ndërtesën
2. Taksa mbi tokën bujqësore
3. Taksa mbi truallin

1. Taksa mbi ndërtesat/banesat

Shkalla e taksës mbi ndërtesat, e cila aplikohet si përqindje e bazës së taksës, është si më poshtë:

Qarku	Bashkia	Njësitë Administrative përbërëse	Çmimi mesatar referues sipas VKM 132	Aplikimi i reduktimit të çmimit referues sipas VKM 132, neni 2, pika 3, paragrafi 2	Ndryshimi i miratuar i çmimit referues	Çmimi referues i miratuar	Reduktim i normës së taksës	
							Familje	Biznes
Elbasan	Belsh	Belsh Grekan Kajan Fierzë Rrasë	35,000	çmimi referues nuk mund të reduktohet		35,000		

Rritje e normës së taksës		Vlera e taksës për metër katror për banesat që përdoren/shfrytëzohen për banim				Vlera e taksës për metër katror për ndërtesat që përdoren/shfrytëzohen për zhvillim aktiviteti				
Familje	Biznes	Shtëpi/ Apartament (1)	Parkim i mbuluar ose bodrum (0.7)	Parkim i hapur (0.3)	Banesa të privatizuara me ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992 (0.7)	Njësi tregtimi dhe shërbimi (1.5)	Parkim i mbuluar ose bodrum (0.7)	Parkim i hapur (0.3)	Njësi industriale, prodhimi, magazinimi (0.5)	Njësi që përdoren për bujqësi ose blegtori (0.3)
		17.50	12.25	5.25	12.25	105.00	49.00	21.00	35.00	21.00

Në zbatim të VKM Nr.132 datë 07.03.2018, dhe për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr 9632 date 30.10.2006 "Per sistemin e taksave vendore " të ndryshuar, parashikohet:

Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen individët, personat fizikë ose juridikë, vendës apo të huaj, pronarë ose përdorues të pasurive të paluajtshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre ndërtesave, përveç rasteve kur në këtë ligj përcaktohen ndryshe. Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen zhvilluesit, të cilët nuk arrijnë të mbyllin ndërtimin sipas lejes përkatëse, të lëshuar nga autoriteti i planifikimit. Afati i përlllogaritjes së taksës fillon nga momenti i mbarimit të afatit kohor të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

Detyrimi për taksën mbi ndërtesat llogaritet si shumëzim i bazës së taksës me shkallën e taksës mbi ndërtesën.

Taksa vendore mbi pasurinë e paluajtshme-ndërtesë llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit. Pagesa e taksës bëhet çdo muaj apo për periudha më të gjata, në varësi të kategorisë së taksapaguesit, sipas përcaktimeve në vendimin e Këshillit të Ministrave.

Shënim: Llogaritja e shumës së taksës së ndërtesës/ njësisë pronësore Njësitë e vetëqeverisjes vendore, duke përdorur të dhënat e mbledhura për ndërtesën/njësinë pasurore, përcaktojnë bazën e taksës dhe llogarisin shumën e taksës vjetore të ndërtesës për t'u paguar nga çdo taksapagues. Baza e llogaritjes së taksës së ndërtesës është vlera e ndërtesës/njësisë pronësore, përcaktuar me një nga metodat e parashikuara në këtë metodologji.

Familjet që nuk kanë kontratë me ujësjellesin, pagesa e taksës së ndërtesës do të bëhet në zyrën e tatim-taksave, Bashkia Belsh ndërsa për njësit administrative (Grekan, Kajan, Rrase, Fierze) pagesa do të bëhet në njësin përkates.

Taksa vendore mbi pasurinë e paluajtshme-ndërtesë paguhet cdo muaj.

Përjashtohen nga taksat mbi ndërtesat:

- a) pronat e shtetit dhe të njësive të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;
- b) pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;
- c) ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara; ç) banesat sociale në pronësi të bashkive;
- d) pasuritë e paluajtshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale; dh) ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;
- ~~e) strukturat akomoduese "Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special", sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht "brand name";~~
- ë) ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që përfitojnë pension pleqërie ose pension social, që janë me banim në fshat ose qytet, kur familja përbëhet vetëm nga pensionistët;
- f) ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;
- g) ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore.”.

N.q.s ndërtesa dëmtohet nga forca madhore përjashtohet nga taksa e ndërtesës me 75% të vlerës dhe n.q.s ndërtesa tjetërsohet ose zhduket gjatë vitit, detyrimi llogaritet me periudhën e të qenit pronar.

Përgjegjësitë e njësisë së vetëqeverisjes vendore

1. Njësia e vetëqeverisjes vendore është autoriteti përgjegjës për administrimin e taksës mbi ndërtesat nën juridiksionin e saj, përmes ushtrimit të funksioneve të mëposhtme:

- a) mbledhjen dhe menaxhimin e informacioneve mbi ndërtesën për qëllime fiskale;
- b) përditësimin e të dhënave të regjistrit qendror të bazës së të dhënave të pasurive të paluajtshme (Kadastra Fiskale);
- c) mbledhjen me forcë të detyrimeve të taksës mbi ndërtesën;
- ç) korrigjimin e të dhënave në lidhje me llogaritjen e taksës, në rastet e saktësimit të informacionit për sipërfaqen, vendndodhjen zonale, çmimet e tregut etj.;
- d) shqyrtimin e ankimit administrativ të taksapaguesve.

P/TATIM-TAKSAVE
Bledar PEPA



KRYETARI
Arif TAFANI
Në mungesë dhe me porosi
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
Mustafa ÇARÇIU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr.Prot 2256/3
Lënda: Konfirmim akti

Elbasan, më 31 . 1 .2019

KËSHILLIT TË BASHKISË BELSH

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.66 dt.17.12.2018 "Për nivelin e taksave vendore , kundravajtjet administrative dhe gjobave në Bashkinë Belsh, si dhe për mënyrën e administrimit të tyre ", dhe pasi u njohëm me të dhënat plotësuese , konfirmoj në parim mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI
Gledian LLATJA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BELSH
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 72 Prot

Belsh, më: 27/12/2018

VENDIM

Nr. 66, Date 17/12/2018

**PËR NIVELIN E TAKSAVE VENDORE, KUNDRAVAJTEVE
ADMINISTRATIVE DHE GJOBAVE NË BASHKINË BELSH, SI DHE PËR
MËNYRËN E ADMINISTRIMIT TË TYRE.**

Mbështetur në ligjin Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 9 Kreu III, pika 1.3 gërma b, neni 35, pika 2,3 dhe 4 të tij, neni 54, gërma f, ku shprehet se Këshilli Bashkiak vendos për llojet e tarifave, nivelin, rregullat bazë për administrimin dhe mbledhjen e tyre, Ligjin Nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar; Ligjin Nr.9920 datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; Ligjin Nr.107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar; si dhe VKM Nr.970 datë 02.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj", me propozimin e Zyrës së Tatim –Taksave, Këshilli Bashkiak Belsh

VENDOSI:

**TË MIRATOJË NIVELET E TAKSAVE DHE TARIFAVE PËR VITIN 2019 NË
BASHKINË BELSH SI MË POSHTË:**

A) TAKSA MBI PASURINË E PALUAJTSHME:

1. *Taksa mbi ndërtesën*
2. *Taksa mbi tokën bujqësore*
3. *Taksa mbi truallin*

**B) TAKSA MBI KALIMIN E SË DREJTËS SË PRONËSISË PËR PASURITË E
PALUAJTSHME**

C) TAKSA MBI NDIKIMIN NË INFRASTRUKTURE:

1. *Për ndërtime të reja*
2. *Për objektet në process legalizimi*
3. *Për autorizime punimesh*

D) TAKSA E TABELËS

E) TAKSA PËR ZËNIEN E HAPSIRËS PUBLIKE (JO TRUALL):

F) TARIFA TË TJERA VENDORE PËR SHËRBIMET QË OFRON BASHKIA

1. *Tarifë pastrimi*
2. *Tarifë ndricimi*
3. *Tarifë gjelbërimi*
4. *Tarifë për zgjatje orari Non Stop*
5. *Tarifë për lëshimin e vërtetimeve*
6. *Tarifë për dhënie në përdorim të ambjenteve*
7. *Tarifë për licencë për tregtimin e hidrokarbureve dhe nënprodukteve të tyre*

G) TARIFA VENDORE TË PËRKOHSHME

1. *Tarifë vjetore për baste sportive, lojra fati etj.*
2. *Tarifë për vaditje*

E) TARIFA PËR TRANSPORTIN

1. *Transport Udhëtarësh*
2. *Transport Mallrash*
3. *Tarifë vjetore parkimi*
4. *Tarifë vjetore pastrimi*
5. *Tarifa të tjera Transporti*

F) GJOBAT DHE KUNDRAVAJTJET ADMINISTRATIVE

A) TAKSA MBI PASURINË E PALUAJTSHME:

Në taksën mbi pasurinë e paluajtshme përfshihen:

1. Taksa mbi ndërtesën
2. Taksa mbi tokën bujqësore
3. Taksa mbi truallin

Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen individët, personat fizikë ose juridikë, vendës apo të huaj, pronarë ose përdorues të pasurive të paluajtshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre ndërtesave, përveç rasteve kur në këtë ligj përcaktohen ndryshe.

Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen personat që kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës, sipas ligjit "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje".

Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen zhvilluesit, të cilët nuk arrijnë të mbyllin ndërtimin sipas lejes përkatëse, të lëshuar nga autoriteti i planifikimit. Afati i përlllogaritjes së taksës fillon nga momenti i mbarimit të afatit kohor të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

1. Taksa mbi ndërtesat/banesat

Detyrimi për taksën mbi ndërtesat llogaritet si shumëzim i bazës së taksës me shkallën e taksës mbi ndërtesën.

Taksa vendore mbi pasurinë e paluajtshme-ndërtesë llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit. Pagesa e taksës bëhet çdo muaj apo për periudha më të gjata, në varësi të kategorisë së taksapaguesit, sipas përcaktimeve në vendimin e Këshillit të Ministrave.

Shkalla e taksës mbi ndërtesat, e cila aplikohet si përqindje e bazës së taksës, është si më poshtë:

Kategorite dhe nenkategorite	% e bazës së taksës
Për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për banim.	0,05%
Për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike	0,2%
E shkallës së taksës përkatëse për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.	30%

Shënim: Baza e taksës mbi ndërtesat është vlera e ndërtesës, që llogaritet në përputhje me metodologjinë dhe procedurat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave. Këshilli i Ministrave, në bazë të vjetërsisë së ndërtesës, mund të specifikojë nënkategori përkatëse.

Familjet që nuk kanë kontratë me ujesjellesin, pagesa e taksës së ndërtesës do të bëhet në zyrën e tatim-taksave, Bashkia e Belsh ndërsa për njësit administrative (Grekan, Kajan, Rrasë, Fierze) pagesa do të bëhet në njësinë përkatëse.

Taksa vendore mbi pasurinë e paluajtshme-ndërtesë paguhet çdo muaj.

Përfshihen nga taksat mbi ndërtesat:

- a) pronat e shtetit dhe të njëjtit të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;
- b) pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;
- c) ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara; ç) banesat sociale në pronësi të bashkive;
- d) pasuritë e paluajtshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale; dh) ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;
- e) strukturat akomoduese "Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special", sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtur të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht "brand name";
- ë) ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që përfitojnë pension pleqërie ose pension social, që janë me banim në fshat ose qytet, kur familja përbëhet vetëm nga pensionistët;
- f) ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;
- g) ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore."

N.q.s ndërtesa dëmtohet nga forca madhore përjashtohet nga taksa e ndërtesës me 75% të vlerës dhe n.q.s ndërtesa tjetërsohet ose zhduket gjatë vitit, detyrimi llogaritet me periudhën e të qenit pronar.

Përgjegjësitë e njësisë së vetëqeverisjes vendore

1. Njësia e vetëqeverisjes vendore është autoriteti përgjegjës për administrimin e taksës mbi ndërtesat nën juridiksionin e saj, përmes ushtrimit të funksioneve të mëposhtme:

- a) mbledhjen dhe menaxhimin e informacioneve mbi ndërtesën për qëllime fiskale;
- b) përditësimin e të dhënave të regjistrit qendror të bazës së të dhënave të pasurive të paluajtshme (Kadastra Fiskale);
- c) mbledhjen me forcë të detyrimeve të taksës mbi ndërtesën;
- ç) korrigjimin e të dhënave në lidhje me llogaritjen e taksës, në rastet e saktësimit të informacionit për sipërfaqen, vendndodhjen zonale, çmimet e tregut etj.;

d) shqyrtimin e ankimit administrativ të taksapaguesve.

2-Taksa mbi tokën bujqësore

Tabela 1.2- Për taksën e tokës bujqësore i propozojmë Këshillit Bashkiak uljen e taksës në nivelin 70%, mbështetur në ligjin 9632, "Për sistemimin e taksave vendore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar.

Tabela 1.2			
Nr	Klasifikimi sipas kategorive të tokës	Vlera 100%/Hektar	Vlera 70%/Hektar =(70 % X Vlerën 100%/Hektar)
1.	Kategoria I	4200 Lekë	2940 Lekë
2.	Kategoria II	3500 Lekë	2450 Lekë
3.	Kategoria III	2800 Lekë	1960 Lekë
4.	Kategoria IV	2300 Lekë	1610 Lekë
5.	Kategoria V	1900 Lekë	1330 Lekë
6.	Kategoria VI	1600 Lekë	1120 Lekë
7.	Kategoria VII	1400 Lekë	980 Lekë

Invalidët e luftës dhe të punës, veteranët e luftës, të semuret tetraplegjikë e paraplegjikë, të verbërit që vërteton statusin me dokument ligjor përjashtohen nga pagimi I taksës së tokës vetëm për sipërfaqen e tokës që ka në pronësi vetë personi sipas Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP-së).

Afati për pagesën e taksës së tokës bujqësore është data **31 dhjetor 2019.**

Përjashtohen nga taksa e tokës bujqësore:

- Përjashtohen nga taksa tokat bujqësore, që mbillen me kultura drufrutorë dhe vreshtari për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes.
- Për taksëpaguesin, pasuria e të cilit është dëmtuar nga veprimi i forcave madhore, jepet lehtësim ose përjashtim i përkohshëm. Kohëzgjatja përcaktohet nga këshilli bashkiak, në raport me dëmin e shkaktuar deri në vlerën 75 për qind.

Struktura e ngarkuar për përlllogaritjen dhe mbledhjen e kësaj takse janë Zyra e Tatim-Taksave pranë Bashkisë Belsh dhe Njësitë Administrative (Rrasë, Fierzë, Grekan, Kajan).

Shënim: Parcelat të cilat nuk kanë të dhëna boniteti, apo për të cilat nuk ka një kategori të përcaktuar, të trajtohen me kategorinë mesatare të zonës ku ndodhen.

3- Taksa mbi Truallin(jo hapësirë publike)

Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit, në metër katror, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim, pranë bashkisë ku ndodhet trualli. Për çdo kategori minimale të truallit, këshilli bashkiak mund të miratojë nënkategorizime. Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit, në metër katror, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim, pranë bashkisë ku ndodhet trualli.

Klasifikimi I taksës	Vlera e taksës në lekë/m2/vit për qëllime banimi nga individët	Vlera e taksës në lekë/m2/vit për qëllime biznesi
Tarifa	0,14 lekë/m2	12 lekë/m2

Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme. Taksa e mbledhur, në mbështetje të këtij ligji, paguhet në buxhetin e bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet prona e taksueshme.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës për truallin është Zyra e Tatim-Taksave pranë Bashkisë Belsh.

B) TAKSA MBI KALIMIN E SË DREJTËS SË PRONËSISË PËR PASURITË E PALUAJTSHME

Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme vendoset për ndërtesat dhe pasuritë e paluajtshme në castin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to. Taksa paguhet nga individ i që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit të pasurive të mësipërme, në përputhje me aktet nënligjore. Pasuria nuk mund të regjistrohet pa paguar detyrimin pranë zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

Niveli I taksës për kalimin e pronësisë mbi ndërtesat sipas aneksit nr.3 të ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” të ndryshuar është si më poshtë:

Nr.		Lekë/m ²
1	Ndërtesë Banimi	100
2	Ndërtesat e tjera për tregti dhe shërbime	300
3	Ndërtesa të tjera	200

Baza e taksës për kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e tjera të paluajtshme është vlera e shitjes së tyre. Niveli I taksës caktohet në përqindje dhe niveli tregues I taksës është 2%. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim I nivelit të taksës me bazën e tij.

Struktura që bën të mundur vjeljen e kësaj takse është Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, e cila në rolin e agjentit të taksave, përfitojnë 3% të shumës së arkëtuar dhe diferencën e derdhit për llogari të buxhetit të bashkisë, jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës.

C) TAKSA MBI NDIKIMIN NË INFRASTRUKTURË:

Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohej të kryhet. Klasifikimi i investimit të ri dhe vlerat përkatëse përcaktohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënie të lejes së ndërtimit. Niveli i taksës sipas kategorive dhe nënkategorive për klasifikimin e investimeve është si mëposhtë:

	Kategoritë e objekteve	Vlera e taksës
1		
	Objekte banimi	1 %
	Objekte shërbimi dhe industriale	3 %
2	Objekte që janë në proces legalizimi	0.5 %

Në rastin e ndërtimeve për qëllime banimi apo njësi shërbimi nga shoqëritë e ndërtimit, të cilat nuk destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, industrisë apo përdorim publik, taksa e ndikimit në infrastrukturë është në masën 4 % të çmimit të shitjes për metër katror. Baza e taksës është vlera në lekë për metër katror e çmimit të shitjes së njësisë të shërbimit apo ndërtesave për qëllime banimi. Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut, sipas përcaktimeve në udhëzimin e Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave", që miratohet çdo vit.

Për projektet e infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, aeroporteve, tuneleve, digave, ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte, taksa e ndikimit në infrastrukturë të ndërtimeve të reja është 0,1 për qind e vlerës së investimit, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar, kur kjo kosto nuk është përfshirë në preventivin e investimit.

Taksa e ndikimit në infrastrukturë për punime me autorizim dhe që sipas ligjit nuk kanë të nevojshme marrjen e lejes së ndërtimit:

Lloji i punimeve		Niveli
a.	Punime me vetëdeklarim dhe që nuk kanë nevojë për leje ndërtimi sipas dispozitave ligjore në fuqi.	5000 lekë/rast
b.	Autorizim për meremetime të vogla dhe që nuk kanë nevojë për leje ndërtimi sipas dispozitave ligjore në fuqi.	2000 lekë/rast
c.	Tarifë për aplikimin për pajisje me leje Zhvillimi të lëshuara nga Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit e Zhvillimit të Territorit	5000 lekë/rast
d.	Tarifë për Certifikatën e Përdorimit për objektet të pajisura me Leje Ndërtimi: - Për objekte banimi (mbi sip. ndërtimi totale) - Për objekte shërbimi, tregtimi, biznese (mbi sip. ndërtimi totale)	50 lekë/m ² 100 lekë/m ²
e.	Taksë për leje Ndërtimi për ndryshimin e Aktiviteteve/Funksioneve	150 lekë/m ²

D) TAKSA E TABELËS

Niveli i kësaj takse për Bashkinë Belsh është si më poshtë:

Nr.	LLOJET E TABELAVE	Nj/matëse	
I.	Tabelë për qëllime identifikimi, deri në 2 metra katror, të trupezuara ose jo, brenda territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtaritë e te treteve		
a.	Deri në 2 m²	Lekë/m ² /vit	0 lekë
b.	Mbi 2 m² deri 10 m²		
	-e thjeshte (pa ndiricim)	Lekë/m ² /vit	7 000 leke
	-me ndiricim te thjeshte	Lekë/m ² /vit	11 500 leke
	-elektronike	Lekë/m ² /vit	15 000 leke

c.	Mbi 10 m² deri 20 m²		
	-e thjeshte (pa ndiricim)	Lekë/m ² /vit	5 950 lekë
	-me ndiricim te thjeshte	Lekë/m ² /vit	9 775 lekë
	-elektronike	Lekë/m ² /vit	12 750 lekë
d.	Mbi 20 m² deri 40 m²		
	-e thjeshte (pa ndiricim)	Lekë/m ² /vit	2 800 lekë
	-me ndiricim te thjeshte	Lekë/m ² /vit	4 600 lekë
	-elektronike	Lekë/m ² /vit	6 000 lekë
II.	Tabela per qellime identifikimi jashte territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit ne formen dhe permasat e tabelave per orientim		
	-tabela identifikuese	Lekë/m ² /vit	120 lekë
III.	Tabela per qellime reklamimi e levizshme, e pa levizshme		
	-e thjeshte (me/ pa ndiricim)	Lekë/m ² /vit	13 500 lekë
	-elektronike	Lekë/m ² /vit	27 000 lekë
IV.	Tabela ne funksion te ekspozimeve te ndryshme te hapura, panaiere, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj.		
	-te te gjitha llojeve te permasave	Lekë/m ² /vit	1 000 lekë

Detyrimi për Taksën e Tabelës për kategorinë 1 dhe 2 është vjetor.

Për “kategorinë 3” detyrimi llogaritet sipas ditëve të përcaktuara në lejen përkatëse të lëshuar nga strukturat përkatëse të bashkisë Belsh dhe paguhet menjëherë.

Për subjektet taksapagues qe vendosin me shume se nje table identifikuese , vetem njera nga dy tabelat identifikuese do te konsiderohet e tille, kurse tabela tjeter do te konsiderohet si reklame.

Çdo table reklame qe kalon siperfaqen 35m², do te konsiderohet sikur eshte 35m² dhe shuma e takses llogaritet dhe paguhet vetem per kete siperfaqe , pavaresisht madhesise se saj ne m².

Struktura e ngarkuar per mbledhjen e kesaj takse per tabelen eshte Drejtoria e Taksave dhe te Vendore. Kontrollit Struktura e ngarkuar per dhenien e lejeve per tabela apo reklama eshte Drejtoria e Planifikimit dhe te Territorit e cila jep dhe lejet per vendosjen e ketyre tabelave. Ky vendim hyn ne fuqi sipas nenit 55 , pika 6 , te ligjit 139/2015 te dates 17.12.2015 "Per veteqeverisjen Vendore ".

E) TAKSA PËR ZËNIEN E HAPËSIRËS PUBLIKE (JO TRUALL):

Hapësirë publike është hapësira e jashtme si rruga, trotuari, sheshi, lulishte parku e të tjera të ngjashme në shërbim të komunitetit, ku menaxhimi mund të jetë publik dhe /ose privat. Hapësirë publike përfshin rrugëkalime publike dhe mjedise që janë të hapura për publikun ose në shërbim të përdorimit publik.

Zënia e hapësirës publike për qëllime biznesi konsiderohet vendosje mallrash jashtë vendit të tregtimit, vendosje tavolinash, sipërfaqet e zëna me platform, sipërfaqe të rrethuara me vazo me lule, bimë dekorative, drurë dekorativë etj.

Baza e taksës për zënien e hapësirës publike është sipërfaqe në m² e cila vihet në shfrytëzim nga individë dhe subjekte për qëllime biznesi. Taksa llogaritet si detyrim mujor i taksapaguesit duke shumëzuar bazën e taksës (sipërfaqen) me nivelin tregues të saj.

	Zënie e hapësirës publike	Nj/matëse
1	Zënie e hapësirës publike për qëllime biznesi	60 lekë/m ² /muaj
2	Zënie e hapësirës publike gjatë zhvillimit të Tregut të Lirë	50 lekë/m ² /dite

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës për zënien e hapësirave publike për qëllime biznesi është zyra e Tatim-Taksave në bashkëpunim me zyrën Juridike për lidhjen e kontratave me subjektet taksapagues.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës për zënien e hapësirës publike në Tregun e Lirë të ndërtuar nga Bashkia Belsh është Inspektori i Tregut.

F) TARIFA TË TJERA VENDORE PËR SHËRBIMET QË OFRON BASHKIA

Tarifat vendosen dhe administrohen në përputhje me ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” ku shprehet se Këshilli Bashkiak vendos për llojet e tarifave, nivelin, rregullat bazë për administrimin dhe mbledhjen e tyre, si dhe përcaktojnë nëse tarifat do të mbliidhen nga vetë strukturat apo nga një agjent.

Tarifat:

- **Pastrimi**
- **Ndricimi**
- **Gjelbërimi**

Tarifës së pastrimit, gjelbërimit, ndricimit I nënshtrohen të gjitha familjet, personat fizik ose juridik, vendas ose të huaj, që banojnë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë Belsh.

I-TARIFA PËR PASTRIMIN:

		Niveli i taksës/Vit
<u>1.</u>	<u>Per familjet</u>	
<u>a.</u>	Per cdo familje qytetare	1000 Leke

Familjet qe nuk kane kontrate me ujesjellesin, pagesa e takses se pstrimit do te behet ne zyren e tatim-taksave , Bashkia Belsh ndërsa për njësit administrative (Grekan, Kajan, Rrase, Fierze) pagesa do te behet ne njesin perkates.

Përfshihen nga taksat pastrimit

kryefamiljarët që përfitojnë pension pleqërie ose pension social, që janë me banim në fshat ose qytet, kur familja përbëhet vetëm nga pensionistët, kryefamiljarët që trajtohen me ndihmë ekonomike, paraplegjiket dhe tetraplegjiket.

2.Per Bizneset:

Nr	Xhiro Vjetore e Biznesit / Njësi shërbimi / Institucione shtetërore	Niveli i taksës/Vit	
		<i>Belsh Qëndër</i>	<i>Njësi administrative dhe periferi.</i>
	LLOJI I AKTIVITETIT	Tarifa/njësi shërbimi	Tarifa/njësi shërbimi
<u>1.</u>	Biznes i vogël, Bar Kafe, Restorant, Tregti industriale, Tregti ushqimor, Minimarket, Shërbime.	5 000	4 000
<u>2.</u>	Furrë Buke, Tregti mishi, Farmaci veterinar, Stomatolog.	6 000	5 000
<u>3.</u>	Përpunim mermeri, përpunim druri dhe serviset.	6 000	5 000
<u>4.</u>	Tregti ushqimor me shumicë, Supermarket, punishte qumështi	20 000	15 000
<u>5.</u>	Karburantet (selia qendrore)	20 000	15 000

<u>6</u>	Karburant(NUIS secondare)	10 000	7 500
<u>7</u>	Biznesi i madh i lëndëve të ndërtimit,nxjerrje dhe përpunim mineralesh dhe gurore.	30 000	20 000
<u>8</u>	Njësi shitje gazi për përdorim familjar	9 000	5 000
<u>9</u>	Biznesi i madh i tregtimit me shumicë dhe pakicë i lëndëve industriale. Mobileri, Alumin, Hidrosanitare.	20 000	10 000
<u>10</u>	Farmaci,farmaci buqësore	20 000	10 000
<u>11</u>	Banka,biznese të mëdha vip, Institucionet e telekomunikacionit.fondacione kredidhënese,OSHE,Ujësjetllsi sha	50 000	40 000
<u>12</u>	Për subjektet me TVSH jo rezidencial,por që krijojnë kantier ndërtimi në Bashkinë Belsh(në propocion të drejte me afatin e lejes së ndërtimit)	100 000	50 000
<u>13</u>	Pëc çdo subjekt ndërtimi	50 000	40 000
<u>14</u>	Institucionet të tjera	15 000	10 000
<u>15</u>	Institucione publike	50 000	40 000
<u>16</u>	Subjektet e kabllorit dhe internetit	30 000	20 000
<u>17</u>	Drejtoria e shërbimit spitalorë.	30 000	20 000
<u>18</u>	Fabrik vaji, punishte rakije,fabrik mielli (tarifë fikse)	10 000	10 000

3.Tarifë pastrimi për subjektet që shfrytëzojnë sipërfaqet liqenore për të kryer aktivitetin ripopullim, zënie dhe tregtim peshku:

Nr	Sipërfaqja e liqenit që shfrytëzohet	Lekë/vit
1	0.1-20 ha	10.000 lekë

2	20.1-50 ha	20.000 lekë
3	Mbi 50 ha	30.000 lekë

II-TARIFA PËR NDRIÇIMIN PUBLIK:

		Niveli I taksës/Vit
<u>1</u>	<u>Per familjet:</u>	
a.	Per cdo familje qytetare	500 Leke

Familjet qe nuk kane kontrate me ujesjellesin, pagesa e taksës se ndiçimit do te behet ne zyren e tatim-taksave , Bashkia Belsh ndërsa për njësit administrative (Grekan, Kajan, Rrase, Fierze) pagesa do te behet ne njesin perkates.

Përfshihen nga taksat e Ndiçimit publik dhe nga Tarifa e Pastrimit.

Kryefamiljarët që përfitojnë pension pleqërie ose pension social, që janë me banim në fshat ose qytet, kur familja përbëhet vetëm nga pensionistët, kryefamiljarët që trajtohen me ndihmë ekonomike, paraplegjiket dhe tetraplegjiket. Këto familje duhet të dorëzojnë pranë zyrave të njësisë administrative ku janë të regjistruara dokumentin që vërteton statusin e tyre dhe gjendjen e tyre familjare.

2.Per Bizneset:

		Belsh Qëndër	Njësi administrative dhe periferi
1	Për biznese të vogla me xhiro vjetore deri në 5000.000 lekë	1000 lekë	800 lekë
2	Për biznese të mëdha me xhiro vjetore mbi 5000.000 lekë dhe institucione shtetërore	3500 lekë	2500 lekë

Shënim: Tarifa për ndiçimin publik paguhet vetëm nga ata banorë, subjekte dhe biznese që u ofrohet ky shërbim.

III-TARIFA PËR GJELBËRIMIN

Nr	Emertimi	Tarifa/lekë
<u>1</u>	<u>Per familjet</u>	
a.	Per cdo familje qytetare	200 lekë

Familjet qe nuk kane kontrate me ujesjellesin, pagesa e takses se gjelbrimit do te behet ne zyren e tatim-taksave , Bashkia Belsh ndërsa për njësit administrative (Grekan, Kajan, Rrase, Fierze) pagesa do te behet ne njesin perkates.

Përfshihen nga taksat gjelbrimit

Kryefamiljarët që përfitojnë pension pleqërie ose pension social, që janë me banim në fshat ose qytet, kur familja përbëhet vetëm nga pensionistët, kryefamiljarët që trajtohen me ndihmë ekonomike, paraplegjikët dhe tetraplegjikët.

2.Per Bizneset

2	Për bizneset nga 0-5000 000 lekë	500 lekë
3	Për bizneset mbi 5000 000 lekë	1000 lekë

Shënim: Tarifa për gjelbërimin paguhet vetëm nga ata banorë, subjekte dhe biznese që u ofrohet ky shërbim.

Familjet me ndihmë ekonomike përjashtohen nga tarifa e pastrimit, gjelbërimi, ndriçimit.

Përjashtohen nga tarifa e pastrimit, ndricimit dhe gjelbërimit invalidët e punës dhe të luftës, të sëmurët tetraplegjikë, paraplegjikë dhe të verbërit kur përfituesi është kryefamiljar dhe e vërteton statusin me dokument ligjor. Nuk e përfitojnë këtë përjashtim familjet kur njëri prej pjesëtarëve të saj sipas certifikatës familjare ushtron aktivitet privat

IV.TARIFË PËR ZGJATJE ORARI “NON STOP”:

1.	Për zgjatje orari 24-h (non-stop)	20.000 lekë/vit
2.	Deri në orën 24 ⁰⁰	10.000 lekë/vit
3.	Për zgjatje orari 24-h (non-stop për një natë)	2.500 lekë/natë

VI.TARIFË PËR LËSHIMIN E VËRTETIMEVE

Nr	Emërtimi	Niveli i taksës/lekë
1.	Vertetim	100 lekë

VII. TARIFË PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË AMBJENTEVE:

Nr.	Emërtimi	Tarifa/ditë
1.	Dhënie në përdorim e shtëpisë së kulturës për aktivitete partiake (për një ditë)	20.000 lekë
2.	Dhënie e shtëpisë së kulturës për aktivitete kulturore dhe fetare (për një ditë)	5.000 lekë
3.	Dhënie e shtëpisë së kulturës për aktivitete Shkollore	0
4.	Tarifë për të gjithë subjektet fizik/juridik që duan të shfrytëzojnë hapësirën publike në rastë festë, evente, panaire, organizime të ndryshme.	20.000 lekë

VIII. TARIFË PËR LIÇENCË PËR TREGTIMIN E HIDROKARBUREVE DHE NËNPRODUKTEVE TË TYRE

Bazuar në vendimin Nr.344, datë 19.4.2017 për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr.970, datë 2.12.2015 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënie e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”.

Nr.	Emërtimi	Tarifa/5 vite
1	Pagesa për dhënie dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburantëve, GLN për automjete e vajrave lubrifikante.	1.000.000 lekë/5 vite (Licencë)
2	Pagesa për dhënie dhe përsëritjen e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse me pakicë për ngrohje dhe gatim (GLN).	100.000 lekë/5 vite (Licencë)

G) TARIFA VENDORE TË PËRKOHSHME:

Nr	Lloji I tarifës	Tarifa
1	Taksë vjetore për Lojra fati, Kazino, Kazino elektronike, baste sportive.	20 000 Lekë/vit
2	Tarifë për vaditje	200 Lekë/dylm

TAKSA E FJETJES NE HOTEL.

	LEKE PER NATE FJETJE
Bujtine, fjetine dhe cdo njesi tjeter akomoduese sipas percaktimeve te ligjit te turizmit.	35 leke/nate fjetje

E)TARIFA PËR TRANSPORTIN:

Tarifat për licensa/autorizime/certifikata

Nr	Emërtimi	Njësia	Tarifa
	<u>TRANSPORT UDHËTARËSH</u>		
1	Licencë për “Transport Udhëtarësh” në linjë të rregullt qytetëse	Për licencë	40 000 lekë/5 vjet
2	Certifikatë për “Transport Udhëtarësh” në linjë të rregullt qytetëse	Për mjet	7 500 lekë/5 vjet
3	Licencë për “Transport Udhëtarësh” në linjë të rregullt rrethqytetëse	Për licencë	20 000 lekë/5 vjet
4	Certifikatë për “Transport Udhëtarësh” në linjë të rregullt rrethqytetëse	Për mjet	7 500 lekë/5 vjet
5	Licencë për “Transport Udhëtarësh” në linjë të rregullt ndërqytetëse brënda qarkut	Për licencë	75 000 lekë/5 vjet
6	Certifikatë për “Transport Udhëtarësh” në linjë të rregullt ndërqytetëse brënda qarkut	Për mjet	7 500 lekë/5 vjet
7	Licencë për transport Udhëtarësh” në linjë të rregullt ndërqytetëse ndërmjet qarqeve	Për licencë	75 000 lekë/5 vjet
8	Certifikatë për “Transport Udhëtarësh” në linjë të rregullt ndërqytetëse ndërmjet qarqeve	Për mjet	7 500 lekë/5 vjet
9	Li çencë për agjensi udhëtarësh	Për liçencë	15 000 lekë/vit
10	Li çencë per transport udhetaresh me taksi	Për liçencë	20 000 lekë/5 vjet

<u>TRANSPORT MALLRASH</u>			
1	Certifikatë transporti malli për të tretë dhe me qera vjetore	Ton/kapcitet	100 lekë (1 vjekar)
2	Certifikatë transporti malli për llogari të vet	Ton/kapcitet	100 lekë (1 vjekar)
3	Çertifikatë për tërheqës dhe makineri shpimi	Për mjet	1 500 lekë/vit
4.	Liçencë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brënda vëndit	Për mjet	40 000 lekë/ 5 vjet
<u>TARIFË VJETORE PARKIMI/QËNDRIMI</u>			
1.	Për taksi 4+1,taksi 8+1 dhe minibus deri në 25 vënde	Për mjet	5000 lekë/vit
2.	Për autobus mbi 25 vënde	Për mjet	9000 lekë/vit
3.	Për transport malli deri 5 ton	Për mjet	3000 lekë/vit
4.	Për transport malli 5-8 ton	Për mjet	4000 lekë/vit
5.	Për transport malli 8- 12 ton	Për mjet	5000 lekë/vit
6.	Për transport malli mbi 12 ton	Për mjet	6000 lekë /vit
7.	Tarife parkimi e rezervuar	Për mjet	15 000 lekë /vit
8	Tarifë parkimi ditor	Për mjet	50 lekë /ditë
<u>TARIFË PASTRIMI PËR SUBJEKTET E TRANSPORTIT</u>			
1	Për taksi 4+1,minibus,autobuz	Për mjet	5 000 lekë/vit
2	Për transport malli deri në 5 ton	Për mjet	2 500 lekë/vit
3	Për transport malli 5-8 ton	Për mjet	3 500 lekë/vit
4	Për transport malli 8-12 ton	Për mjet	4 000 lekë/vit
5	Për transport malli mbi 12 ton	Për mjet	5 000 lekë/vit
<u>TARIFA TË TJERA TRANSPORTI</u>			
1.	Autorizim ditor(për transport udhëtarësh me autobus jashtë linje për vizita,eskursionet etj -Për brenda rrethit (Për autorizim) -Për jashtë rrethit (Për autorizim)	Për mjet	200 lekë/ditë 500 lekë/ditë

2.	Leje ditore për hyrje në qytet	Për mjet	5 00 lekë/ditë
3.	Leje mujore për hyrje në qytet	Për mjet	2000 lekë /muaj
4.	Leje tre mujore për hyrje në qytet	Për mjet	5000 lekë/muaj

Shënim: Për vjeljen e këtyre tarifave ngarkohet inspektori i transportit pranë Bashkisë Belsh.

F)GJOBAT DHE KUNDRAVAJTJET ADMINISTRATIVE

Nr	Lloji I gjobës	Lekë
*	Aplikim gjobash për	
1.	Hedhje mbeturinash në rrugë	1000 - 5000 lekë/rast
2.	Gjobë për ndërhyrjen në rrugë e trotuare	10 000 - 15 000 lekë/rast
3.	Gjobë për ndërhyrje në ndricimin publik	10 000 - 15 000 lekë/rast
4.	Gjobë për bllokimin e rrugëve të arave	5 000 - 10 000 lekë/rast
5.	Gjobë për zaptim dhe punim të tokës shtetërore	5 000 - 10 000 lekë
6.	Gjobë për therje bagëtish në ambjente publike	1 000 - 5 000 lekë/rast
7.	Gjobë për ndërtim pa leje	15 000 - 25 000 lekë/rast
8.	Gjobë për ushtrimin e aktivitetit të transportit të udhëtarëve pa liçencë	1 000 - 5 000 lekë/rast
9.	Hyrja e mjeteve me tonazh të lartë në rrugët kryesore të qytetit pa autorizim	1 000- 5 000 lekë/rast
10.	Mos pajisje me leje për tregtimin e karburanteve dhe bomblave të gazit	10 000- 20 000 lekë
11.	Vendosje tabelash, reklamash, banderolash pa leje	1 000 - 10 000 lekë
12.	Zënie të hapësirës së gjelbër pa leje	5 000 - 20 000 lekë
13.	Dëmtim i hapësirave publike të gjelbërta	10 000 - 20 000 lekë
14.	Mos pajisje me leje për tregti ambulante	1 000 - 5 000lekë

15.	Mos paisje me leje për shërbim me tavolina jashtë lokalit	5 000 - 20 000 lekë
-----	---	---------------------


Shënim:Për zbatimin e kësaj pike si dhe vjeljen këtyre gjobave apo kundravajtjeve administrative ngarkohet sektori i Policisë Bashkiake, Inspektoriati Vendor I Mbrojtjes së Territorit (IMT) si dhe Sektori i veterinarisë pranë bashkisë.

AFATI I PAGESËS PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE

- *Për subjektet e biznesit të vogël afati i pagesës brenda datës 31/03/2019 të vitit fiskal. Për subjektet e reja në momentin kur lind detyrimi tatimor.*
- *Për bizneset e mëdha brenda datës 31/07/2019 të vitit fiskal*
- *Për familjet brenda datës 31/12/2019 (taksat familjare dhe taksa e tokës)*
- *Kamatevonesa do aplikohet mbas mbarimit të afatit të fundit 31/07/2019*

Ky Vendim hynë në fuqi sipas percaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefekti të Qarkut Elbasan.

KRYETARI KËSHILLIT
Bujar BLOKU






REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr. 2256/ Prot.

Elbasan më 4.1.2019

Lënda: Mbi ligjshmërinë e aktit.

KËSHILLIT TË BASHKISË BELSH

Në zbatim të nenit 16 , të ligjit nr.107/2016 dt.27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut” u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj Nr.66 dt.17.12.2018 " *Për nivelin e taksave vendore, kundravajtjeve administrative dhe gjobave në Bashkinë Belsh , si dhe për mënyrën e administrimit të tyre*”, akti juaj konfirmohet në përjashtim të pikës A të vendimit, pasi sipas V.K.M nr.132 datë 07.03.2018 nuk është përcaktuar qartë metodologjia për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”si dhe nivelet treguese të taksës për kategoritë dhe nënkategoritë e ndërtesës.

Deri në plotesimin e këtyre të dhënave pika A e aktit tuaj mbetet e pa konfirmuar.

PREFEKTI

Maksim MALAJ

